



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI**

Nr. 177/1 Prot.

Vlorë, më, 30.10.2020

VENDIM


Nr.16, datë 30. 10. 2020

MBI FILLIMIN E VITIT AKADEMIK 2020- 2021 NË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rektorati në mbledhjen e datës 30.10.2020

VENDOSI

1. Procesi mësimor në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë për vitin akademik 2020 - 2021 nis në datën 02. 11. 2020.
2. Ndodhur në kushtët e pandemisë Covid- 19, procesi mësimor, gjatë muajit nëntor, në rubrikat leksione dhe seminare, do të zhvillohet online përmes platformës Google dhe aplikacionit Google Meet dhe Google Classroom.
3. Grupe të vogla dhe të reduktuara studentësh, me kërkesën e tyre, mund të ndjekin elemente të procesit mësimor (laboratore, seminare, konsultime etj) edhe me prezencë fizike në auditore, duke respektuar rigorozisht protokollat e sigurisë për COVID- 19.
4. Praktikat profesionale për studentët e programeve të studimit të FSH, do të zhvillohen normalisht në spitalet rajonale apo bashkiake të vendbanimeve të tyre.
5. Autoritetet drejtuese, stafi akademik, stafi ndihmës akademik me karakter administrativ dhe stafi administrativ i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, pavarësisht zhvillimit online të procesit akademik do të respektojnë orarin zyrtar në institucion.
6. Stafi akademik do ta zhvillojë procesin mësimor online kryesisht në ambjentet akademike të fakulteteve përkatëse ose, në raste pamundësish objektive, mund ta kryejë procesin mësimor në mjedise të tjera të përshtatshme për ta.
7. Autoritetet drejtuese të njëjësive bazë dhe kryesore, përgjegjësit e grupeve mësimore, kordinatorët e studentëve dhe gjithë personeli akademik i UV të marrin masa të veçanta me qellim që studentet e viteve të para të njihen me rregullat e funksionimit të procesit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI**

mesimdhënës të programin e studimit ku janë regjistruar si dhe te njihen me procedurat e zhvillimit te procesit rñesimdhënies ne distancë.

8. Ky vendim i përcillet për miratim Senati Akademik si një shtesë në vendimin e tij nr. 92, datë 21. 10. 2020 "Për shqyrtim dhe miratimin e propozimeve për mënyrat e zhvillimit të planit mësimor për vitin akademik 2020- 2021 në kushtet e pandemisë COVID- 19"
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike dhe administrative të UV.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në SA dhe shpalljes së tij nga Rektori.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

